



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:042310

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644400

P.nr.45A/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit V. G, i akuzuar për veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.3549/22 të datës 02.08.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 24.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Eset Rama dhe të akuzuarit V. G., me datë 24.04.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 30.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari V. G, i biri i H. dhe nëna L, e gjinisë Paloja, i lindur me 10.09.1999, në Prishtinë, me vendbanim në Lagjen “B.B.” Rr. “.....” Prishtinë, me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datën 07.07.2022, rreth orës 02:10, në fshatin M.... saktësisht në pompën e derivateve “S. P.”, i pandehuri V. G., nën ndikim të alkoolit, i cili sipas matjes me alkool test ka rezultuar në 0.90 % promil, duke mos e përshtatur shpejtësinë ka rrezikuar trafikun publik dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, ashtu që në gjendje të dehur ka drejtuar automjetin e tij të tipit VW Golf 1K, me targa 01-455-NE, me ngjyrë të bardhë, duke lëvizur shumë shpejtë në rrugë dhe me të arritur në rreth rrotullimin e fshatit M. e godet cepin e rrethit me rrotën e majtë ku dhe e humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit, hyn në parkingun e pompës se derivateve të lartcekur dhe fillimisht e godet automjetin e tipit Chrysler Daimler me targa CJ-800-MC, ngjyrë hiri, pastaj godet një shtyllë të metaltë dhe gjeneratorin e pompës, me ç ‘rast i shkakton dëme materiale të dëmtuarit I. M.-përfaqësues i pompës së derivateve “S. P.” dhe dëmtime të lehta trupore pëson tani i dëmtuari I. M. të cilat paraqesin kontuzione në krahun e dorës së majtë me besueshmëri të shkaktuara nga ndonjë mjet i fortë dhe i rëndë mbretës.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur* nga neni 371 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 23, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 371 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

- I.** Në shumën prej 500.00 (pesëqind) Euro të cilin dënimi i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- II.** Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësojë me dënim burgu në kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III.** Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.3549/22 të datës 02.08.2023, ndaj të akuzuarit V. G. për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paafte apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së.

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 24.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Eset Rama dhe të pandehurit V. G. ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori, i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit V. G.

qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën nga pakujdesia, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa rrethana rënduese nuk janë konstatuar nga Gjykata.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 43 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.45A/23 datë 30.04.2024**

Gjyqtarja e vetme Gjyqesore

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.